



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial
- * Aktivitetet për profesionet e tjera ligjore
- * Aktivitetet tjera

Janar 2020

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit

Më 28 janar 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin me temë “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e drejtë të normave dhe kriteve ligjore lidhur me rrethanat në të cilat mund të vendoset, duke përfshirë dhe standardet e aplikueshme që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për aplikim të paraburgimit si masa më e rëndë që mund të përcaktohet për sigurinë e të pandehurit në procedurë gjyqësore.

Në fokus të trajnimi ishte paraburgimit si masë me të cilën sigurohet prezenca e të

pandehurit si dhe mbrojtja e qytetarëve nga kryesi i veprës penale duke arritur efikasitet në procedurën penale, pastaj u elaboruan thirrja, urdhërarresti, premtimi i të pandehurit që nuk do ta braktis vendqëndrimin, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni dhe çështja e paraburgimit.

Metodologjia e zbatuar për realizimin e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Shqyrtimi paraprak i padisë dhe seanca përgatitore

Më 30 janar 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) organizoi trajnimin me temë: “Shqyrtimi paraprak i padisë dhe seanca përgatitore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shqyrtimi paraprak të padisë si fazë e veçantë e procedurës kontestimore.

Në pjesën e parë të trajnimit u diskutua rreth çështjeve që lidhen me prezumimet procedurale, klasifikimin, prezumimet procedurale lidhur me gjykatën, palët, me objektin e kontestit dhe prezumimet procedurale lidhur me padinë. Në vazhdim janë trajtuar vendimet e gjykatës për ndalimin e pengesave procedurale, hedhja poshtë e padisë si e palejuar, ekzistimi i kompetencës territoriale dhe i asaj lëndore si prezumim procedural dhe shtyrja e vendosjes për disa çështje si dhe përgjigja në padi.

Shqyrtimi paraprak i padisë është nën fazë e detyrueshme e përgatitjes së shqyrtimit kryesor

të çështjes juridike. Kjo fazë fillon që nga momenti i ngritjes së padisë dhe zgjatë deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor. Në vazhdim u fol për kompetencën e përgjithshme territoriale, Kompetenca e veçantë territoriale, Kompetenca territoriale ekskluzive, Kompetenca territoriale e zgjedhur.

Në vazhdim është diskutuar caktimi dhe mbajtja e seancës përgatitore, ku gjykata e cakton këtë seancë, pasi që të arrijë përgjigja në padi e të paditurit, e nëse i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, e nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, gjykata duhet që ta thirre seancën përgatitore pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e përgjigjes me shkrim në padi. Po ashtu u tha se gjykatat duhet të jenë të kujdesshme kur vendosin që padinë ta kthejnë në plotësim sepse duhet të kërkojnë nga paditësi paraqitjen e fakteve.

Përfitues të këtij aktiviteti ishin gjyqtarët e gjykatave themelore të divizioneve civile dhe bashkëpunëtorët profesional.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit janar është vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar. Janë realizuar gjithsejtë 16 sesione trajnuese nga modulet: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale, dhe Rendi juridik ndërkombëtarë.

Nga nën moduli: “Vendi i ngjarjes dhe forenzika” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku janë diskutuar çështjet e bazës ligjore, mënyrës së veprimit në çastet e para, krijimi i versioneve të ndryshme të ngjarjes dhe pyetjet e arta të kriminalistikës që paraqiten në vendin e ngjarjes si dhe klasifikimi dhe komunikimi i vendit të ngjarjes, faza informative, statistike, kontrolluese dhe përgatitore.

Në kuadër të nën modulit: “Parashkrimi” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese ku prokurorët e sapo emëruar kanë pasur mundësi të zgjerojnë njohuritë e tyre rreth natyrës juridike të parashkrimit dhe kohëzgjatjen e ndjekjes penale sipas Kodi Penal të Republikës së Kosovës dhe fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale.

Një sesion trajnues është realizuar nga nën moduli: “Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë” ku u trajtua për marrëveshjen e pranimit të fajësisë në gjykatë, prezentimin dhe shqyrtimin dhe sistemet juridike të cilat e aplikojnë këtë institut.

Po ashtu, gjatë këtyre sesioneve trajnuese nga nën moduli: “Procedurat e veçanta sipas KPPK” janë shtjelluar edhe procedurat ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës dhe procedurat penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime

mendore, përgjegjshmeria esenciale e zvogluar - ndikimi i saj në përgjegjësinë penale dhe sanksioni sipas KPRK-së si dhe caktimi i paraburgimit ndaj të miturit me çrregullime mendore.

Në kuadër të nën modulit: “Ushtrimi i mjeteve juridike” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto çështje: Përpilimi i ankesës nga prokurori i shtetit për shkak të shkeljes së ligjit penal, ankesa kundër aktgjykimit lidhur më vendimin mbi sanksionet penale dhe vendimeve tjera dhe vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur më ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në bazë të seancës së kolegjit ose në bazë të shqyrtimit.

Gjithashtu nga nën moduli: “Shpenzimet e procedurës” është realizuar një (1) sesion trajnues ku prokurorët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesat pasurore juridike, vendimin dhe shqyrtimin për shpenzimet e procedurës penale dhe anulimi i veprimit të caktimit juridik.

Nga nën modulet “Marrja dhe komunikimi i vendimeve” dhe “Vija ndarëse mes veprave penale dhe kundërvajtjeve” janë realizuar dy sesione trajnuese ku janë trajtuar: komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave, llojet e vendimeve, procedura për marrjen e vendimeve në seancë për këshillim dhe votim nga trupi gjykues si dhe procedurës dhe aktvendimit mbi kundërvajtjet, fillimi dhe zhvillimi i procedurës dhe dorëzimi i aktvendimit mbi kundërvajtjet.



Në kuader të trajnimit teroik gjithashtu janë realizuar edhe dy (2) sesione trajnues nga nën modulet: “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështje penale” si dhe “E drejta Kushtetuese” ku prokurorët patën mundësinë të përfitojnë njohurit të reja për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në Kosovë, vendimi për lejueshmërinë apo mos lejueshmërinë e ekstradimit dhe mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet inteligjencës dhe

agjencitë për zbatim të ligjit si dhe burimet e së drejtës kushtetuese në Republikën e Kosovës, gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe referimi incidental.

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të realizimit të trajnim praktik në prokurori, konform orarit të përcaktuar prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar gjithsej 12 ditë nga trajnimi praktik.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar

Gjatë muajit janar është vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar. Janë realizuar gjithsejtë 16 sesione trajnuese nga modulet: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale, dhe Rendi juridik ndërkombëtarë.

Nga nën moduli: “Vendi i ngjarjes dhe forenzika” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku janë diskutuar çështjet e bazës ligjore, mënyrës së veprimit në çastet e para, krijimi i versioneve të ndryshme të ngjarjes dhe pyetjet e arta të kriminalistikës që paraqiten në vendin e ngjarjes si dhe

klasifikimi dhe komunikimi i vendit të ngjarjes, faza informative, statistike, kontrolluese dhe përgatitore.

Në kuadër të nën modulit: “Parashkrimi” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese ku prokurorët e sapo emëruar kanë pasur mundësi të zgjerojnë njohuritë e tyre rreth natyrës juridike të parashkrimit dhe kohëzgjatjen e ndjekjes penale sipas Kodi Penal të Republikës së Kosovës dhe fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale.

Një sesion trajnues është realizuar nga nën moduli: “Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë” ku u trajtua për marrëveshjen e pranimit të fajësisë në gjykatë, prezentimin dhe shqyrtimin dhe sistemet juridike të cilat e aplikojnë këtë institut.

Po ashtu, gjatë këtyre sesioneve trajnuese nga nën moduli: “Procedurat e veçanta sipas KPPK” janë shtjelluar edhe procedurat ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale në ndikimin e alkoolit ose drogës dhe procedurat penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore, përgjegjshmeria esenciale e zvogluar- ndikimi i saj në përgjegjësinë penale dhe sanksioni sipas KPRK-së si dhe caktimi i paraburgimit ndaj të miturit me çrregullime mendore.

Në kuadër të nën modulit: “Ushtrimi i mjeteve juridike” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto çështje: Përpilimi i ankesës nga prokurori i shtetit për shkak të shkeljes së ligjit penal, ankesa kundër aktgjyqimit lidhur më vendimin mbi sanksionet penale dhe vendimeve tjera dhe vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur më ankesën kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në bazë të seancës së kolegjit ose në bazë të shqyrtimit.

Gjithashtu nga nën moduli: “Shpenzimet e procedurës” është realizuar një (1) sesion trajnues ku prokurorët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesat pasurore juridike, vendimin dhe shqyrtimin për

shpenzimet e procedurës penale dhe anulimi i veprimit të caktimit juridik.

Nga nën modulet “Marrja dhe komunikimi i vendimeve” dhe “Vija ndarëse mes veprave penale dhe kundërvajtjeve” janë realizuar dy sesione trajnuese ku janë trajtuar: komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave, llojet e vendimeve, procedura për marrjen e vendimeve në seancë për këshillim dhe votim nga trupi gjykues si dhe procedurës dhe aktvendimit mbi kundërvajtjet, fillimi dhe zhvillimi i procedurës dhe dorëzimi i aktvendimit mbi kundërvajtjet.

Në kuader të trajnimit teroik gjithashtu janë realizuar edhe dy (2) sesione trajnues nga nën modulet: “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështje penale” si dhe “E drejta Kushtetuese” ku prokurorët patën mundësinë të përfitojnë njohurit të reja për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në Kosovë, vendimi për lejueshmërinë apo mos lejueshmërinë e ekstradimit dhe mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet inteligjencës dhe agjencitë për zbatim të ligjit si dhe burimet e së drejtës kushtetuese në Republikën e Kosovës, gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe referimi incidental.

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të realizimit të trajnimit praktik në prokurori, konform orarit të përcaktuar prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar gjithsej 12 ditë nga trajnimi praktik.



Teknologjia informative

Më 15 Janar 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve Fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar të komuniteti serbë (gjenerata e VII) , realizoi trajnimin nga moduli: “Teknologjia informative”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte aftësimi në përdorimin e TI dhe programeve kompjuterike në procesin e punës në gjykata.

Me rastin e këtij trajnimi u diskutua për rëndësinë e teknologjisë, e cila mundëson arritjen e informatave përmes Outlook, përdorimi i programit të “Wordit”, i cili përdoret për shkrimin e vendimeve gjyqësore dhe akteve tjera, si dhe formën e zëvendësimit dhe kombinimet e ndryshme të programeve kompjuterike në “Smil”. Me theks të veçantë

gjatë realizimi të këtij trajnimi është diskutuar për parapërgatitjen e stafit, i cili do të punojë me SMIL si në aspektin e njohurive të përgjithshme në TI po ashtu edhe në aspektin psikologjik.

Gjyqtarët e sapo emëruar të komunitetit serbë patën rastin të përfitojnë edhe për sistemet kompjuterike dhe të rrjeteve sociale ku në fokus përfshihen të gjitha të dhënat bazë nga gjyqësori si formulimet dhe arkivimin e dokumenteve mbi konfidencialitet të plotë.

Përfitues të trajnimit janë: Gjyqtarët e sapo emëruar të komunitetit serbë (gjenerata e VII), 2019-2020.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor – Gr. III”

Më 30-31 janar 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Programin e USAID për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë – JSSP, realizuan trajnimin me temë “Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor –Gr.III”.

Ky trajnim kishte për qëllim avancimin e njohurive të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor sa i përket temës së përkthimit konsektiv apo marrjes së shënimeve.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan këto tema: rëndësia e përkthimit konsektiv (video i shkurtë për rëndësinë e marrjes së shënimeve), analiza e fjalimit, hartat e strukturës dhe hartat e mendjes.

Në ditën e dytë u trajtuan: identifikimi dhe

ndarja e ideve, softverët e përkthimit - trajnim i avancuar për përdorimin e tradosit dhe roli i tij.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, metodologjitë e reja për përkthim konsektiv, raste nga praktika e përkthimeve në gjykata dhe prokurori duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbrëthyer standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin përkthyesit e gjykatave dhe prokurorive të të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe nga Akademia e Drejtësisë.



Aktivitetet për profesionet e tjera ligjore

Shqyrtimi paraprak i padisë dhe i kërkesë padisë


Më 21 Janar 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar trajnimin me temë: “Shqyrtimi paraprak i padisë dhe i kërkesë padisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që zyrtarët për ndihmë juridike falas të përfitonin njohuri të reja lidhur me përmbushjen e prezumimeve procedurale për zhvillimin e drejtë të procedurës kontestimore dhe veprimet e gjykatës në këtë fazë të procedurës.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan temat: Vlerësimi i kompetencës gjyqësore, zgjedhja

meritore e kontestit dhe hedhja poshtë e padisë si e pavlefshme. Në formë të bashkë bisedimit me trajnuesit u diskutuan edhe raste nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas lidhur me çështjet problematike të kësaj natyre, me theks të veçantë u shtejllua vlerësimi i kompetencës gjyqësore, vlerësimi i gjyqësive (Lidispendenca) ose vendimi i fazës ku merren vendimet si dhe vlerësimi i çështjes së gjykuar të formës së prerë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 18 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjione.



Mënyra e fitimit të pasurisë dhe mbrojtja e saj

Më 22 Janar 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it , ka realizuar trajnimin me temë: “Mënyra e fitimit të pasurisë dhe mbrojtja e saj”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që zyrtarët për ndihmë juridike falas ti thellojnë njohurit e tyre dhe të zbatojnë drejtë ndihmën juridike në kontestet pronësore.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan temat si në vijim: Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë, mbrojtja e të drejtës së pronësisë në përgjithësi dhe paditë për mbrojtjen e pronësisë si në

kontestin vendor ashtu edhe nga perspektiva e praktikës së GJEDNJ-së

Trajnimi u realizua në formë të bashkë bisedimit ku pjesëmarrësit parashtuan edhe pyetje lidhur me çështjet problematike të pronësisë, autorizimet, kufizimet si dhe mbrojtjen e saj, krahasimin dhe llojet e padive për mbrojtjen e pronësisë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 18 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjione.



Aktivitetet tjera

Sjelljet etike dhe vështrimi i përgjithshëm sa i përket Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve

Më 21 janar 2020, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimin për stafin e saj me temë “Sjelljet etike dhe vështrimi i përgjithshëm sa i përket Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi në respektimin e sjelljes etike dhe vendosjen e standardeve të integritetit moral dhe udhëzimeve për sjellje të hijshme personale dhe profesionale të stafit.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan çështjet rreth sjelljes etike si dhe parimet e saj. Vëmendje iu kushtua rritjes së cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve dhe standardeve etike në përputhje me Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paañësia, pavarësia, konfidencialiteti, shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia. Po ashtu gjatë këtij trajnimi u theksua që stafi gjithnjë duhet të shmangë sjelljet që mund të krijojnë atmosferë jo miqësore, stresuese, frike, pasigurie apo forma

tjera të përluljes. Më tej u tha që për të pasur një prestigj dhe imazh të mirë ka nevojë që stafi i akademisë të respektojë rregullat dhe standardet etike jo vetëm gjatë kohës sa është në zyre në orarin e punës, por edhe jashtë zyrës, sepse ata paraqesin pasqyrën e të punësuarve në Akademi.

Në vazhdim u trajtua Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, ku çdo person i cili raporton ose shpalo informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik, ka të ngjarë shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet apo kur personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor, sinjalizuesi ka mbrojtje ligjore që të bëjë sinjalizimin e brendshëm, të jashtëm apo publik.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi i Akademisë së Drejtësisë.

Trajnim i trajnuesve lidhur me “Udhëzuesin për përdorimin e HUDOC”

Më datë 22 Janar 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP dhe Institucionin e Avokatit të Popullit, organizoi trajnim për trajnues lidhur me “Udhëzuesin për përdorimin e HUDOC”.

Qëllimi i trajnimit ishte që gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë në cilësinë e trajnuesve, të informohen lidhur me mundësitë e kërkimit dhe përmbledhjen e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut – HUDOC.

Gjatë trajnimit u diskutua përmbajtja e kësaj platforme e cila është e pasur me aktgjykime, vendime, përmbledhje juridike, dhe raste tjera të vendosura nga GJEDNJ. Gjithashtu u sqarua

edhe procedura e procesit të kërkimit të vendimeve dhe filtrimit të informacioneve sipas shteteve, gjuhës, neneve etj.

Pjesëmarrësit shpalosën dhe përfitimet nga kjo platformë, dhe mundësitë e avancimit të mëtutjeshëm, me qëllim të marrjes së vendimeve në mënyrë më të shpejtë dhe efikase.

Përfitues të trajnimit ishin: Gjyqtarët dhe Prokurorët.



Takimi me ekspertët e angazhuar nga projekti i financuar nga BE- Mbështetje e Kodit Civil-faza e II

Më 23 janar 2019, në Akademinë e Drejtësisë është zhvilluar takimi me ekspertët e angazhuar nga projekti i financuar nga BE-Mbështetje e Kodit Civil-faza II, z. Haxhi Gashi, njëkohësisht Dekan i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës dhe z. Bashkim Preteni, profesor në këtë universitet në të cilin u diskutua përfshirja e një pako të trajnimeve të cilat përfshijnë ndryshimet legislative të Kodit Civil të Republikës së Kosovës.

Me rastin e këtij takimi u pajtua që në kurrikulën trajnuese të trajnimeve të vazhdueshme të përfshihen 6 sesione trajnuese me 8 ditë trajnimi në të cilat do të trajtohen institute të ndryshme me theks të veçantë tek

çështjet pronësore, familjare, trashëgimore dhe detyrimore.

Po ashtu u pajtua që këto aktivitete trajnuese të realizohen në periudhën mars- korrik si dhe u diskutuan edhe detaje tjera rreth metodologjisë trajnuese duke përfshirë edhe përfituesit e këtyre trajnimeve nga radhët e gjyqtarëve kompetent.

Nga Akademia e Drejtësisë në takim përveç Drejtorit të Akademisë morën pjesë edhe stafi nga Departamenti i Programit.



Takimi me trajnuesit nga radhët e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor

Me 23 Janar 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve të saj në bashkëpunim me Programin e USAID për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë – JSSP, ka realizuar takimin me trajnuesit e përzgjedhur nga radhët e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor.

Qëllimi i këtij takimi ishte që përkthyesit dhe interpretët gjyqësor të përgatiten në cilësinë e trajnuesve, dhe të ndihmojnë në bartjen e njohurive në të ardhmen tek përkthyesit tjerë me qëllim të përmirësimit të përkthimit në procedurat gjyqësore si dhe sigurimit që palët të

kenë qasje dhe përfaqësim të barabartë në gjuhët zyrtare të Kosovës.

Një ndër pikat kryesore të këtij takimi ishte metodologjia e shpjegimit dhe mënyrat e përdorimit të Softuerëve të Përkthimit apo përdorimin e Tradosit.

Përfitues të këtij takimi ishin përkthyes dhe interpret gjyqësor të përzgjedhur si rezultat i sesioneve të trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2019.



Takim fillestar luftimi i fluksit të paligjshëm financiar në Ballkanin perëndimor



Me 28 janar 2020, nën organizimin e partneritetit gjermano – norvegjez, në Shkup të Maqedonisë është zhvilluar “Takimi fillestar luftimit të fluksit të paligjshëm financiar në Ballkanin perëndimor”.

Qëllimi i këtij takimi fillestar ishte që të mbledhen të gjitha autoritetet përkatëse në vendet partnere të Ballkanit Perëndimor për t'u

njohur me qëllimin e projektit, si dhe për të prezantuar aktivitetet e përgjithshme të programit që do të zbatohen në Ballkanin Perëndimor në periudhën e 2020-2022.

Gjatë takimit janë prezantuar komponentët e Programit Global për Luftimin e Flukseve Financiare të Paligjshme të implementuara nga GIZ. Ky program do të përqendrohet në përmirësimin e transparencës së pronësisë në biznes, vendosjen e regjistrave të llogarive bankare, parandalimin e transportit të paligjshëm të parave, zhvillimin e kapaciteteve në zbatimin e ligjit dhe angazhimin e shoqërisë civile.

Në këtë takim, Akademia e Drejtësisë mori pjesë në cilësinë e institucionit për trajnime gjyqësore dhe u përfaqësua nga Drejtori Ekzekutiv z. Enver Fejzullahu dhe znj. Melihate Rama, Udhëheqëse e PTV-së.



Punëtori: “Zhvillimi i kurrikulës së trajnimit të Trajnerëve (ToT) për gjyqtarë dhe prokurorë mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave”

Më 28 dhe 29 Janar 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, organizuan punëtorinë (ToT) me temë: “Zhvillimi i kurrikulës së trajnimit të Trajnerëve (ToT) për gjyqtarë dhe prokurorë mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të sigurohet që kurrikula e ToT të adresoj sfidat specifike me të cilat përballen gjyqtarët dhe prokurorët në zbatimin e ligjeve penale në Kosovë, sigurimin që metodologjia e propozuar e trajnimit të jetë efektive dhe të konceptohet drafti final lidhur me trajnimet në këtë fushë.


Gjatë punëtorisë janë diskutuar çështje si: Raste nga Konventa e Stambollit, sfidat e trajnimit të rasteve me dhunë në familje,

identifikimi i nevojave për trajnim në fushën kundër dhunës në familje/dhunës ndaj gruas, martesat e dhunshme, krimet e ashtuquajtura “Krime të nderit” etj.

Gjatë punëtorisë janë zhvilluar edhe punë praktike të ndara në grupe nga pjesëmarrësit.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë nga gjitha nivelet, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, zyrtarë ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë si dhe nga zyra për mbrojtjen e viktimave.





Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>